



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:085555

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05771327

**C. nr. 251/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, përmes gjyqtarit Artan Abazi, me bashkëpunatorin profesional Blerand Sopi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.M. nga ..... të cilin e përfaqëson me autorizim Shefqet Rexha, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson me autorizim Alban Hashani, jurist nga Kamenica, me objekt kontesti për anulimin e vendimit me numër 06/2023, të datës 27.02.2023, të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, më datën 10.05.2024 mori, ndërsa më datën 03.06.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** ne tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit R. M. nga ..... dhe;

**II. ANULOHET** vendimi me numër 06/2023, i datës 27.02.2023, i Kryetarit të Komunës së Kamenicës, për emërimin e kandidatit Selami Klaiqi, në pozitën e drejtorit, në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë, si i kundërligjshëm, dhe njëkohësisht **DETYROHET** e paditura, që pas anulimit të vendimit të lartëcekur, çështjen t’ua kthej në pikën fillestare, të gjitha këto brenda afatit prej 7 ditëve, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

**III. OBLIGOHET** e paditura, që të paditurit, t’ia kompenzoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë të përgjithshme prej 529.00 euro, brenda afatit prej 7 ditëve, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

**A r s y e t i m**

**1. Rrjedha e procedurës**

Paditësi R.M. nga ....., përmes të autorizuarit të tij Shefqet Rexha, avokat nga Kamenica, më datën 30.03.2023, në këtë Gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson me autorizim Alban Hashani, jurist nga Kamenica, me objekt kontesti për anulimin e vendimit me numër 06/2023, të datës 27.02.2023,

të Kryetarit të Komunës së Kamenicës, për emërimin e kandidatit S. K., në pozitën e drejtorit, në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë.

## **2. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse**

I autorizuari i paditësit, avokati Shefqet Rexha nga Kamenica, në seancën përgaditore dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke kërkuar nga gjykata anulimin e vendimit me numër 06/2023, i datës 27.02.2023, i Kryetarit të Komunës së Kamenicës, për emërimin e kandidatit S. K., në pozitën e drejtorit, në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë, si të kundërligjshëm, ngase ka deklaruar se konsideron se në këtë konkurs është lehtësisht e dallueshme që kemi të bëjmë me shkelje të ddispozitave ligjore të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ me numër 151/2020, ku janë të përcaktuara qartë kushtet dhe kriteret që duhet ti plotësojnë kandidatët për tu emëruar në pozitën e drejtorit në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë. I autorizuari i paditësit po ashtu ka theksuar se kandidati Selami Klaiqi, i emëruar pozitën e drejtorit në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë, nuk i ka plotësuar kriteret në bazë të Udhëzimit Administrativ të lartëcekur, pasi që ky kandidat ka kualifikim bachelor i Inxhinierisë kompjuterike, me 180 kredi(etc) drejtimi 3 vjeçar, dhe i njëjti nuk i përket drejtimit të profilit arsimor dhe për këtë arsye bie në kundërshtim me nenin 5 të Udhëzimit administrativ 151/2020. Tutje ka theksuar se përbërja e komisionit nuk është në pajtim me Udhëzimit Administrativ 151/2020, pasi që anëtari i këtij komisioni R. G., nuk i ka plotësuar kushtet siq janë të përcaktuara në paragrafin 3, nënparagrafi 3.1 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ 151/2020. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se e paditura Komuna e Kamenicës – DKA, nuk ka vepruar drejt dhe në harmoni me dispozitat ligjore relevante, që janë në fuqi në Republikën e Kosovës, në këtë procedurë të rekrutimit duke bërë shkelje dhe dikriminim me rastin e përzgjedhjes së kandidatit për pozitën Drejtor në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë. Andaj, ka i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe ta anuloj vendimin me numër 06/2023, i datës 27.02.2023, i Kryetarit të Komunës së Kamenicës, për emërimin e kandidatit S. K., në pozitën e drejtorit, në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë, si i kundërligjshëm. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 529.00 euro.

I autorizuari i të paditurës, Alban Hashani, jurist nga Kamenica, në seancën përgaditore dhe gjatë shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjegjies në padi dhe e kundërshton në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar për shkak se ka theksur që procedurat lidhur me përzgjedhjen e drejtorit të Shkollës “Ismail Qemali” janë zhvilluar në tërësi sipas Udhëzimit Administrativ me numër 151/2020 dhe Ligjit për Zyrtarët public. Tutje ka theksuar se sa i përket pretendimeve të paditësit se kandidati i përzgjedhur nuk i ka plotësuar kushtet në këtë konkurs, nuk qëndron, ngase ka shtuar se edhe në mendimin e Komisionit të Ankesave ku është refuzuar ankesa e paditësit, është specifikuar se kandidati i përzgjedhur i ka plotësuar kushtet ligjore sipas Udhëzimit Administrativ me numër 151/2020, për shkak se i njëjti ka të përfunduar fakultetin e Edukimit, ndërsa gradën master e ka me specializim në Teknologji. Po ashtu i njëjti ka theksuar se meqenëse me asnjë nga provat materiale nuk është bërë e beseshme padia dhe kërkesëpadia e paditësit, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i komisionit të ankesave me numër 9476.

### **3. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor**

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: Kontrata e punës në emër të R.M., me numër 0429062 e datës 10.03.2022, vendimi i Komisionit për Ankesa, i datës 17.03.2023, i lëshuar nga Komuna e Kamenicës, Diploma e studimeve themelore në emër të R.M., Ankesa e parashtruar nga R.M. e datës 07.03.2023, konkursi për plotësimin e vendit të lire të punës i datës 09.12.2022, njoftimi i datës 21.02.2023, i lëshuar nga Komuna e Kamenicës, për rezultatet e arritura të kandidatëve, Dosja komplete e kandidatit S. K. duke përfshirë diplomat e shkollimit të tij, çertifikatat, formularët e vlerësimit të tij nga Komisioni dhe dokumentet tjera personale, dëgjimi i dëshmitarit R. G., dëgjimi i paditësit R. M. në cilësi të palës.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha sëbashku, konform dispozitës së nenit 8, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Gjykata, ka gjetur se për paditësin, kontestuese ishte plotësimi i kushteve themelore të konkursit, nga kandidati S. K., i përgjedhur në pozitën e Drejtorit në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë.

#### **2.1. Provat materiale**

Në bazë të Shpalljes të konkursit për plotësimin e vendeve të punës, i shpallur nga Komuna e Kamenicës – Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Kamenicë, i datës 08.01.2023, gjykata e vërtetoi faktin se, Komuna e Kamenicës, ka shpallur konkurs për pozitën Drejtor në 8 shkolla në Komunën e Kamenicës, ku mes tjerash 1 pozitë për Drejtor në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Komunën e Kamenicës, me kushtet e përcaktuara në këtë konkurs, e cila është edhe objekt kontesti.

Në bazë të Ankesës së datës 07.03.2023, të paraqitur nga paditësi R.M., në Komisionin për Ankesa pranë Komunës së Kamenicës, gjykata vërtetoi faktin se, paditësi me datë 07.03.2023 i është drejtuar me ankesë Komisionit Komunal për Ankesa pranë Komunës së Kamenicës, lidhur me pretendimet e tij për emërimin e S. K. në pozitën e Drejtorit në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë.

Në bazë të vendimit të Komisionit për Ankesa për Nënpunësit e Shërbimit Publik të Komunës së Kamenicës të datës 17.03.2023, gjykata vërtetoi faktin se komisioni me vendim e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit me numër 02/7611, të datës 07.03.2023 dhe e ka lënë në fuqi vendimin e Kryetarit të Komunës së Kamenicës me numër 02/6380 të datës 27.02.2023, për emërimin e drejtorit të SHML Gjimnazi “Ismail Qemali” Kamenicë z.Selami Klaiqi.

Në bazë të diplomës së studimeve themelore në emër të R. M., gjykata vërtetoi faktin se paditësi R. M., ka të përfundur Fakultetin e shkencave matematike-natyrore Dega e Fizikës pranë Universitetit të Prishtinës.

Nga konkursi për plotësimin e vendit të lire të punës të datës 09.12.2022 për pozitën e Drejtorit, gjykata e vërtetoi faktin se Komuna e Kamenicës, ka shpallur konkurs për pranimin e 8 Drejtorëve në nivel Komuna dhe atë dy pozita për dy Shkolla të Mesme të Larta dhe 6 pozita tjera për Shkolla Fillore të Mesme të Ulëta, me kontratë me kohë të caktuar për periudhën 4 vite.

Në bazë të njoftimit, me numër Nr.5926, i datës 23.10.2023, i lëshuar nga Komuna e Kamenicës, gjykata vërtetoi faktin se, Komisioni përkatës ka bërë listimin e kandidatëve pas rezultateve të intervistimit, ku S. K. është notuar me 95.33 pikë, si i pari, ndërsa paditësi R.M. me 84.5 pikë, si i treti.

Nga dosja complete e kandidatit S. K., gjykata vërtetoi faktin se, S. K. me datë 02 Qershor 2009, ka përfunduar studimet themelore dhe ka marrur titullin Baçelor i Inxhinierisë Kompjuterike, ku ka të grumbulluara gjithësej 180 pikë-kredi (ECTS), ndërsa me datë 9 tetor 2020, ka marrur titullin Master i Mësimdhënies Lëndore me Spacializim në Teknologji dhe Tik, ku ka të grumbulluara 120 pikë-kredi (ECTS). I njejtë ju ka nënshtruar intervistimit me datë 09.12.2022 është notuar me pikët 95.33 dhe është rekomanduar nga ana e komisionit për tu emëruar në pozitën e drejtorit të Gjinnazit “Ismajl Qemali” në Kamenicë.

## **2.2. Dëshmia e dëshmitarit R. G.**

Dëshmitari R. G. nga ....., në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 18.03.2024, ka deklaruar se ka qenë anëtar i komisionit për përzgjedhjen e Drejtorit të shkollës “Ismajl Qemali” në Kamenicë, në konkursin e datës 09.12.2022, ndërsa në konkursin në fjalë Drejtor i shkollës “Ismail Qemali” në Kamenicë është zgjedhur profesori S. K., i cili është edhe mësimdhënës në Gjinnazin në fjalë dhe e jep lëndën e Teknologjisë informative. Tutje ka deklaruar se e njofton gjykatën që komisioni i përbërë nga tre anëtarë themelohet në bazë të Udhëzimit Administrativ për përzgjedhjen e drejtorëve, dhe dy anëtarë prej tyre i themelon Kuvendi Komunal, përmes votive të anëtarëve të Kuvendit Komunal prej të cilëve anëtarë njëri duhet të jetë zyrtar i DKA dhe tjetri mund të jetë i profilit ish drejtor mirëpo mund të jetë edhe mësimdhënës me performance të lartë, ndërsa personi i tretë caktohet nga Ministria e Arsimit, tutje dëshmitari ka theksuar se Komisioni Intervistues në bazë të shqyrtimit të dokumentave të paraqitura nga kandidatët, ka ardhur në përfundim dhe ka konstatuar se të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për Drejtor të shkollave në Komunën e Kamenicës, respektivisht kandidatët R.M. dhe S. K., i plotësojnë të gjitha kushtet formale në bazë të Udhëzimit Administrativ për përzgjedhjen e drejtorëve për të kandiduar për Drejtor në Gjinnazin “Ismajl Qemali” në Kamenicë ku si dëshmi është edhe formulari i posaqëm i nënshkruar nga të tre anëtarët e komisionit. dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ për përzgjedhjen e drejtorëve, përshkruhet saktë se cili kandidat i plotëson kushtet, ashtu që në pikën numër 1 të cekur në konkurs përcaktohet kushti master arsimor me 300 kredi, ndërsa në bazë të vlerësimit të dokumenteve të paraqitura nga S. K., i njejtë e kishte plotësuar këtë kusht. Në fund dëshmitari ka theksuar se konsideron se si Komision në terësi i kanë respektuar të gjitha procedurat dhe kriteret e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ, për përzgjedhjen e drejtorëve në konkursin e datës 09.12.2022.

## **2.3. Deklarata e paditësit R. M.**

Paditësi R. M. nga ....., në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 18.03.2023, ka deklaruar se në shkollën “Ismajl Qemali” në Kamenicë punon që nga viti 1995, që 25 vite si profesor i fizikës dhe ka qenë edhe drejtor i Gjimnazit “Ismajl Qemali” në Kamenicë, në vitin 2021 ku mandati i tij ka zgjatur vetëm 4 muaj sepse kundërkandidati S. K. ishte ankuar në Inspektoratin e Arsimit në Gjilan dhe Kryetari i Komunës në vitin 2021 e kishte larguar nga pozita e Drejtorit me arsyetim të vendimit të Inspektoratit të Arsimit në Gjilan. Tutje ka theksuar se në konkursin e hapur nga DKA në Komunën e Kamenicës, të datës 09.12.2020, ka kandiduar për Drejtor të Gjimnazit “Ismajl Qemali” në Kamenicë, mirëpo nuk është pranuar si drejtor dhe është rradhitur i 3ti në listë, ndërsa si drejtor ishte zgjedhur S. K. i cili është mësimdhënës i Gjimnazit “Ismajl Qemali” në Kamenicë dhe sipas mendimit të tij nuk i ka plotësuar kushtet në bazë të Konkursit dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ për zgjedhjen e drejtorëve të shkollavem, ku neni 6 i këtij udhëzimit përcakton se në Arsimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë (Gjimnaze) dhe qendra burimore, kandidat duhet të jetë i profilit arsimor, në bazë të normativit profesional të arsimit të përgjithshëm, ndërsa S. K. shkollimin bazik e ka në profilin teknik, për këtë arsye në dy konkurset e më hershme i njejt i ishte eliminuar për përzgjedhur si Drejtor i shkollës, ku edhe ishte bërë kërkesë nga DKA që të ndërrohet Komisioni i mëhershëm ku zyrtari i lartë i njësisë së Arsimit nuk ka pranuar që ta ndërroj komisionin tutje paditësi ka theksuar se S. K. i cili është zgjedhur si Drejtor është dashur ti ketë 240 etc të profilit Arsimor, ndërsa i njejt i ka vetëm 120 kredi të profilit të edukimit, dhe mendon se nuk e ka profilin bazë për këtë arsye mendon se është eliminuar dy herë më herët dhe në bazë të udhëzimit administrativ 151/2020, profili i kandidatit S.K. nuk i plotëson kushtet për tu zgjedhur Drejtor. Tutje paditësi ka theksuar se lënda e Inxhinierisë Kompjuterike të cilën e jep mësimdhënësi S.K. në Gjimnazin “Ismajl Qemali” është paraparë në kurikulën Arsmiore të DKA në Komunën e Kamenicës, mirëpo e njejt është lëndë e profilit teknik, dhe mendon se i është bërë e padrejtë nga Komisioni përzgjedhës e po ashtu nga Komisioni i Ankesave që ka vendosur lidhur me ankesën e tij dhe padrejtësinë i njejt konsideron se të njejt ja kanë bërë për shkak të ndikimeve politike, tutje ka theksuar se përsëri e njofotn gjykatën që në bazë të udhëzimit administrativ, nr.151/2020 profili i fakultetit të edukimit shkollimi bazik bachelor, 240 kredi minimale i plotëson kriteret për të qenë drejtor në Gjimnaz, ndërsa Drejtor në Gjimnaz nuk mund të jetë profili i fakultetit Teknik, respektivisht profesor i lëndëve të Inxhinierisë Kompjuterike. Po ashtu paditësit ka theksuar se në konkursin për përzgjedhjen e Drejtorve në Komunën e Kamenicës nuk ka pas test me shkrim por vetëm intervistë me gojë, dhe kjo mënyrë e përzgjedhjes së Drejtorëve është konform Udhëzimit Administrativ për përzgjedhjen e Drejtorëve, tutje paditësi ka theksuar se anëtarë të Koisionit për përzgjedhjen e drejtorëve kanë qenë 3, dhe se nuk ka pasur ankesë me rastin e intervistimit ndaj asnjërit nga antarët e Komisionit dhe se Komisioni e ka intervistuar dhe i ka parashtruar pyetje dhe atë që të tre anëtarët e komisionit, ndërsa kur e ka parë listën e përzgjedhjes së Drejtorit të Gjimnazit “Ismajl Qemali” dhe e ka kuptuar se nuk është përzgjedhur, ka paraqitur ankesë në kuadër të Komunës së Kamenicës, kundër listës së përzgjedhjes së Drejtorit.

#### **4. Baza juridike**

Duke u bazuar në dispozitën e nenit 78 paragrafi 1, të Ligjit të Punës, me Nr. 03/L-2012, ku përcaktohet se “*I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies*

së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura” ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se “Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës”, si dhe në bazë të paragrafit 3, të po të këtij neni “Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh”, po ashtu në dispozitën e nenit 79 të Ligjit të Punës së lartëcekur, përcaktohet se “Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2, të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”, si dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 34 paragrafi 2 të Ligjit për Zyrtarët Publik (Ligji Nr. 06/L – 114), ku përcaktohet se “Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë”, ndërsa në paragrafin 4 të po këtij neni përcaktohet se “Njoftimi për hapjen e procedurës të konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 21 ditë, nga data e përcaktuar për paraqitjen e aplikimit, nga njësia përgjegjëse, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Afati për pranimin e aplikacioneve nuk mund të jetë më i shkurtër se 8 dite dhe jo më i gjatë se 15 ditë kalendarike”. Po ashtu duke u bazuar në paragrafin 6, 7 dhe 8 të dispozitës së nenit 34 të Ligjit të lartëcekur, përcaktohet se “Konkurrimi zhvillohet në dy faza, verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit vlerësimi i njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i pranimit (në vijim: Komisioni i pranimit), i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë për të cilin zhvillohet konkurrimi, Testimi, vlerësimi dhe publikimi i rezultatit bëhet në mënyrë elektronike dhe sigurohet anonimiteti i konkurrentëve”. Gjithashtu në nenin 20 të Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën E Kosovës përcaktohet se “Drejtori dhe zëvendës drejtori i institucionit arsimor dhe aftësues zgjidhen në bazë të Ligjit mbi arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr 03/L-068, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga MASHT me akt nënligjor, duke i shtuar edhe dy përfaqësues të Këshillit drejtues në cilësinë e vëzhguesve në komisionin e përbashkët të emërimit.” Ndërsa në nenin 35 paragrafi 5 të po të njejtij ligj përcaktohet se “Kur bëhet përzgjedhja midis një apo më shumë kandidatëve për një post menaxhues ose për mësimdhënës, merren për bazë kushtet, si janë: arsimimi i secilit kandidat, përvoja, kualifikimet për pozitë dhe nevojat që do të plotësojë ky emërim. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk i plotëson kushtet për kualifikim të përcaktuar në këtë ligj, mund të bëhet një emërim i përkohshëm. Emërimet e tilla përfundojnë në ditën e fundit të vitit shkollor gjatë të cilit është bërë emërimi”. Ndërsa me Udhëzimin Administrativ 151/2020 në nenin 5, janë të përcaktuara kushtet që duhet ti plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs për pozitën Drejtor ku shprehimisht përcaktohet se “Kushtet që duhet ti plotësojnë kandidati/ja për të marrë pjesë në konkurs, 1. Kandidati/ja i/e interesuar duhet t'i plotësojë këto kushte: 1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm dhe normativit për arsim profesional në fuqi: 1.2.1. Master për udhëheqje, administrim ose

*menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar); 1.2.2. Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar); 1.2.3. Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar); 1.2.4. Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar); 1.3. Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve; 1.4. Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH sipas rekomandimit të KSHLM;*

Nga të lartëcekurat, gjykata erdhi në përfundim se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në ligj dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

### **5. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës**

Duke i pasur parasysh provat materiale, dëshmin e dëshmitarit dhe deklaratën e vet paditësit, të cekura si më lartë dhe pas analizimit dhe vlerësimit me kujdesë të tyre, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit R.M., është e bazuar në ligj, ashtu që në bazë të këtij konstatimi gjykata ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësit përmes së cilës ka kërkuar realizmin e kërkesave të lartëcekura, t'a aprovoj si të bazuar, sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Deri të ky përfundim gjykata ka ardhur duke e pasur parasysh faktin se edhe pse në asnjërën fazë të rekrutimit në konkursin për plotësimin e vendeve të punës, i shpallur nga Komuna e Kamenicës – Kamenicë, i datës 09.12.2022, për pozitën Drejtor, në shkollën e Mesme të Lartë, në Kamenicë, paditësit R.M., nuk i është mohur asnjë e drejtë, pasi që nga provat materiale dhe vet deklarata e paditësit të cekura dhe elaboruara si më lartë, vërtetohet se komisioni i pranimit në këtë konkurs, ka konstatuar se paditësi i plotëson kriteret formale të përcaktuara me konkursin e lartëcekur, për të aplikuar në pozitën drejtor dhe të njëjtin e ka futur në listen përfundimtare për të vazhduar tutje në fazat e rekrutimit të konkursit të lartëcekur. Po ashtu, gjykata ka vërtetuar edhe faktin se paditësi R.M., është ftuar dhe i është nënshtruar intervistës me gojë, e në të cilën intervistë ka grumbulluar 84.5 pikë, dhe duke u renditur si kandidati i 3-të, në listë të cilin fakt gjykata e ka vërtetuar në bazë të provës materiale, respektivisht në bazë të njoftimit me numër 04 – 5926, të datës 21.02.2023, dhe nga i njëjti njoftim gjykata vërtetoi faktin se paditësi nuk ka arritur t'i grumbulloj pikët e mjaftueshme për t'u përzgjedhur për pozitën e Drejtorit në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë. Ndërsa në anën tjetër në bazë të shpalljes të konkursit për plotësimin e vendeve të punës, i shpallur nga Komuna e Kamenicës, i datës 09.12.2022, për pozitën Drejtor, në shkollën e Mesme të Lartë, në Kamenicë, gjykata e vërtetoi faktin se Komuna e Kamenicës, ka shpallur konkurs për pranimin e 8 Drejtorëve në nivel Komunal dhe atë dy pozita për dy Shkolla të Mesme të Larta dhe 6 pozita tjera për Shkolla Filllore të Mesme të Ulëta, me kontratë me kohë të caktuar për periudhën 4 vite, me kushtet e përcaktuara në këtë konkurs, e që nga të gjitha këto prova materiale u vërtetua se kandidati, tani paditësi R. M., në bazë të komisionit të pranimit, nuk ka arritur të grumbulloj pikët e mjaftueshme për tu përzgjedhur për pozitën në të cilën ka aplikuar, pra, për pozitën drejtor në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë, ndërsa në të njëjtën pozitë ishte përzgjedhur kundërkandidati S. K.. Gjithashtu gjykata e ka vërtetuar edhe faktin se paditësi meqenëse nuk ishte përzgjedhur në listën përfundimtare si Drejtor në

Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë, kishte bërë ankesë më datën 07.02.2023 pranë Komisionit për Ankesa për Nënpunësit e Shërbimit Publik, ndërsa e njehta me datë 17.03.2023 ishte refuzuar si e pabazuar nga Komisioni për Annkesa për Nënpunësit Publik. Andaj, edhe pse pas të gjitha këtyre të lartëcekurave vërtetohet se paditësit nuk i është mohur asnjë e drejtë lidhur më konkursin e lartëcekur, megjithatë gjykata gjeti se për sa i përket kriterëve formale dhe të domosdoshme, të cilat është dashur t’i plotësojnë kandidatët për të aplikuar në konkursin e lartëcekur, kandidati i përzgjedhur S. K. nga ..... nuk i ka plotësuar kushtet themelore për t’iu nënshtruar konkursit, i cili është objekt i kësaj çështje kontestimore, dhe gjykata pas vlerësimit dhe administrimit të të gjitha provave dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, erdhi në përfundim se duhet të aprovohet kërkespacia e paditësit si e bazuar në ligj, ngase në rastin konkret, kandidati i përzgjedhur si më i suksesshmi, pra, S. K., nuk i ka plotësuar kushtet themelore në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.151/2020, Për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm për ti ju nënshtruar konkursit për drejtor, kjo ngase bazuar në nenin 5 të këtij Udhëzimi Administrativ të lartëcekur, për të ju nënshtruar konkursit për të njejtën pozitë, kandidati duhet ti plotësoj këto kushte: .....1.2.1. *Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);* 1.2.2. *Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);* 1.2.3. *Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);* 1.2.4. *Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar),* ndërsa në anën tjetër, gjykata ka vërtetuar faktin se kandidati i përzgjedhur, pra, S. K., në konkursin për drejtor, në pozitën e drejtorit në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë, i cili është objekt i këtij kontesti, në Studimet Themelore Universitare të përfunduara pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, ka gjithësej 180 pikë-kredi (ECTS), ndërsa në studimet Master i Mësimdhënies Lëndore (me specializim në Teknologji dhe Tik) të përfunduara pranë Universitetit “Hasan Prishtina”, në Fakultetin e Edukimit, ka të grumbulluara gjithësej 120 pikë-kredi (ECTS), fakte këto të cilat gjykata i ka vërtetuar në bazë të diplomës së studimeve themelore dhe diplomave të studimeve master, në emër të S. K., pasi që i njëjti, me datë 02 Qershor 2009 ka përfunduar studimet themelore dhe ka marrur titullin Baçelor i Inxhinierisë Kompjuterike, ku ka të grumbulluara gjithësej 180 pikë-kredi (ECTS), ndërsa me datë 9 tetor 2020 ka marrur titullin Master i Mësimdhënies Lëndore me Spacializim në Teknologji dhe Tik ku ka të grumbulluara 120 pikë-kredi (ECTS). Andaj, pas analizimit me kujdesë të diplomave të lartëcekura, në emër të kandidatit S. K., të përzgjedhur në pozitën e drejtorit në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë, dhe analizimit me kujdesë të dispozitave ligjore të lartëcekura, gjykata ka ardhur në përfundim se S. K., nuk i ka plotësuar kriteret themelore për ti ju nënshtruar konkursit, për pozitën e drejtorit në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë, e rrjedhimisht as të emërohet si drejtor në këtë shkollë, dhe vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket dëshmisë së dëshmitarit R. G., gjykata të njëjtës nuk i’a fali besimin dhe nuk e mori për bazë me rastin e vendosjes ne këtë çështje juridike kontestimore, pasi që Gjykata, përmes provave materiale, respektivisht nga diplomat e shkollimit të studimeve themelore dhe të masterit, të kandidatit të përzgjedhur në bazë të konkursit të kontestuar, S.K., në pozitën e



drejtorit në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë, nuk i ka plotësuar kriteret themelore për tu emëruar në këtë pozitë për shkaqët dhe rrethanat, të cilat janë elaboruar si më lartë.

**6. Shpenzimet e procedurës kontestimore**

Gjykata, vendosi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore duke u mbështetur në nenin 449 dhe 452 paragrafi 1, të LPK-së, dhe në bazë të Tarifës së OAK-së, dhe e detyroj të paditurën, që të paditësit, t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 529.00 euro, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00 euro, në emër të përfaqësimit në 3 (tri) seanca gjyqësore për secilën veç e veç nga 135.00 euro, respektivisht shumë prej 405.00 euro, si dhe në emër të taksës gjyqësore, për paraqitjen e padisë shumë prej 20.00 euro.

Duke u bazuar në të lartëcekurat, si dhe në dispozitën e nenit 143, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**  
**C. nr. 251/2023, i datës 03.06.2024**

**G j y q t a r i,**  
Artan Abazi, d. v

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 7 ditëve, pas di=atës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.